Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Gani Nekaj	**11.08.2023**	**22.08.2023**	**2023/0558**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 09.08.2023, OE “" ProAudit " SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0558, kundër njoftimit për kontratë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “" ProAudit " SH.P.K.”- Prishtinë, apo kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Angazhimi i konsulentit te jashtem per mbeshtetjen e procesit te Ristrukturimit ne NPQ,Posta e Kosoves sha” me nr. të prokurimit: "vetak-23-6535-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POSTA E KOSOVËS SH.A.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedur? t? hapur, negocuar, kufizuar, lloji i kontrat?s: pun?, furnizim, sh?rbim, vlera e parashikuar e kontrat?s: xx,xxx €.Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0558 i dt:09.08.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Pretendimet Ankimore te Operatorit Ekonomik janë:

- Sipas operatorit ekonomik dispozitat e shkelura te Ligji për Prokurim Publik Nr. 04/L-042 nga ana e Autoritetit Kontraktues gjatë vlerësimit te ofetave janë:

1 Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, përkatësisht ritenderimi si procedur e re duke

angazhuar staftin profesional në ketë procedure dhe shtyerja e afatit kohor në sigurimin e

ketyre shërbimeve janë disa nga demet që mund ti shkaktohen AK.

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi paragrafi - 6. Gjatë udhëheqjes së

aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (vi) që tenderi

i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe

specifikimeve përkatëse.

Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale – duke konsideruar mundesit e aplikomit

si Indivit apo OE dhe kriteri përmbajtësor CV e stafit si dhe vendimi nga BD për

aprovimin e rregulloret për sistemantizimin vendeve të punës që në përmbatje nënkupton

raport i pranimit të shërbimëve AK është dashur të konsideroj përmbatjen mbi formën.Gjithashtu ka shkleur edhe dispozitat përkatëse te RRUOPP.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet e parqitura nga OE ankues

Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, përkatësisht ritenderimi si procedur e re duke angazhuar staftin profesional në ketë procedure dhe shtyerja e afatit kohor në sigurimin e ketyre shërbimeve janë disa nga demet që mund ti shkaktohen AK.

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi paragrafi - 6. Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse.

Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale – duke konsideruar mundesit e aplikomit si Indivit apo OE dhe kriteri përmbajtësor CV e stafit si dhe vendimi nga BD për aprovimin e rregulloret për sistemantizimin vendeve të punës që në përmbatje nënkupton raport i pranimit të shërbimëve AK është dashur të konsideroj përmbatjen mbi formën.

KRITERET PËR VLERËSIM

Ne vijim janë paraqitur kriteret e vlerësimit vetëm ato qe kanë te bëjnë me pretendimet ankimore.

Kërkesat; Kapaciteti teknik dhe profesional

Kerkesat e nevojshme për Aplikim si Operator Ekonomik

1.CV per personin pergjegjes qe do te angazhohet ne kete aktivitet te prokurimit

2. Operatori ekonomik (ose Grupi) gjatë tri viteve të shkuara (nga data e publikimit të njoftimit për kontrate) duhet të kenë të përfunduara një apo disa sherbime të njëjta apo të ngjajshme.

3. Raporti i finalizuar ne 3 vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit per kontratë

4.Letër motivuese e OE Të shpjegoni pse jeni te interesuar për këtë punë, si përvoja dhe aftësitë e juaja te ju përshtaten për këtë rol.

Dëshmitë: Kapaciteti teknik dhe profesional

Deshmite e kerkuara për Aplikimin si OE

1.CV-ja duhet të përmbajë informacion te detajuar për përvojën profesionale, aftësinë dhe edukimin per personin pergjegjes qe do te angazhohet ne kete aktivitet te prokurimit.

2.Një liste qe specifikon sherbimet e kryera nga ana e operatorit ekonomik (ose Grupit), shumën e kontratës, datën dhe pranuesin. Listes duhet ti bashkangjitet kopje dëshmitë përkatëse; kur sherbimet janë bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij sherbimi-kryerje sherbimesh duhet kopja e kontratës dhe referenca apo raporti i pranimit të lëshuar ose të bashkë nënshkruara nga autoriteti i tillë;kur sherbimet janë bërë për një operator privat, për dëshmi të kryerjes shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga marresi i sherbimeve respektivisht kopja e kontratës dhe evidentimi i sherbimit.

3.OE duhet te paraqet nje raport që eshte përgatitur ne 3 vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit per kontrate dhe që është i ngjashëm me atë që do të kërkohet në këtë angazhim.

4.Me leter motivuese OE duhet të shpjegoj pse jeni te interesuar për këtë punë, si përvoja dhe aftësitë e juaja ju përshtaten për këtë rol (aktivitet te prokurimit).

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

DEKLARATË

Komisioni i vleresimit ka shqyrtuar dokumentet e pranuar nga i vetmi OE qe ka ofertuar "ProAudit Shpk" dhe permes letres standarde ka kerkuar sqarime per kerkesen se nga :
OE duhet te dorezohet nje raport qe ne 3 vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit per kontrate është i ngjashëm me atë që do të kërkohet në këtë angazhim si dhe nje liste qe specifikon sherbimet e kryera nga ana e operatorit ekonomik (ose Grupit), shumën e kontratës, datën dhe pranuesin. Listes duhet ti bashkangjitet kopje dëshmitë përkatëse; kur sherbimet janë bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij sherbimi-kryerje sherbimesh duhet kopja e kontratës dhe referenca apo raporti i pranimit të lëshuar ose të bashkë nënshkruara nga autoriteti i tillë;kur sherbimet janë bërë për një operator privat, për dëshmi të kryerjes shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga marresi i sherbimeve respektivisht kopja e kontratës dhe evidentimi i sherbimit.
OE ka bashkangjitur disa dokumente si sqarime rreth kerkeses tone:

Sqarime me shkrim permes letres standarde te dt 26.07.2023 ne te cilen ka potencuar respektivisht sqaruar CV-ne me poziten e z.Hajdar Hoxhaj i cili ka qene Kryeshef Ekzekutiv i Nderrmarjes NPB-se dhe nga janari i vitit 2023 eshte angazhuar si konsulent i jashtem i OE-"ProAudit"Shpk. Eshte sqaruar situata se i njejti sa ka qene KE i NPB-se ne asistimin e stafit perkates ka hartu "Rregullore per sistematizimin e vendeve te punes ne Ndermarrjen Publike Banesore sh.a Prishtine me nr te protokolit 01-475/3 te dt 25.03.2021 dhe struktures e re organizative te NPB-se,i njejti ka ofruar listen e puneve te kryera te dt 26.07.2023 ne te cilen liste ka potencuar se ka kryer Rregulloren, vetem "Rregullore per sistematizimin e vendeve te punes ne ndermarrjen publike banesore sh.a Prishtine me nr te protokolit 01-475/3 te dt 25.03.2021,ka bashkangjitur listen e punetoreve te ATK-se me te cilen vertetohet se Hajdar Hoxhaj eshte punetor i "ProAudit", eshte bashkangjitur vendimi i nenshkruar nga kryesuesja e NPB-se lidhur me plotesimin dhe ndryshimin e Rregullores per sistematizimin e vendeve te punes ne NPB te dt 25.03.2021 me protocol 01-475. Vendimin e dt 14.0202020 me nr protokoli 02-214/1 me te cilen z.Hajdar Hoxhaj eshte emeruar KE i nderrmarjes NPB-se ,Vendimin e dt 30.04.2018 me nr protokoli 14-112/02-101979/18 me te cilin z.Hoxhaj eshte emeruar KE i NPB-se si dhe eshte ofruar si deshmi kopja e faqes se pare te "Rregullore per sistematizimin e vendeve te punes ne Ndermarrjen Publike Banesore sh.a Prishtine me nr te protokolit 01-475/3 te dt 25.03.2021.

Pervec kesaj AK ka kerkuar sqarim nga ana e Autoritetit : "Nderrmarja publike banesore rreth "Rregullore per sistematizimin e vendeve te punes ne ndermarrjen publike banesore sh.a Prishtine me nr te protokolit 01-475/3 te dt 25.03.2021 se nga kush eshte punuar kjo rregullore. Nderrmarja Publike Banesore permes e-mailit te dt 27.07.2023 ka kthyer pergjigjen se kjo rregullore eshte punuar nga grupi punues i cili perbehet nga punonjesit e NPB-se, te cilet jane percaktuar ne rolet dhe detyrat e tyre ne realizimin e rregullores per sistematizimin e vendeve te punes. Baren kryesore te pergatitjes se rregullores e ka bart Drejtori i Administrates, dhe e njejta rregullore eshte reviduar nga Sekretari Koorporativ, si dhe eshte aprovuar nga Bordi i Drejtoreve.
Sqarimet e cekura me larte dhe deshmite e ofruara nga OE i ka analizuar komisioni i vleresimit dhe ka ardhur ne perfundim se OE "ProAudit" Shpk si dhe stafi i saj me konkretisht z.Hajdar Hoxhaj nuk kane ofruar deshmi te mjaftuara se te njejtit kane perfunduar vet sherbim te ngjajshem sic eshte kerkuar me kerkesen e parashtruar nga AK-Posta e Kosoves sepse te njejtit fare nuk kane ofruar reference apo raport pranimi lidhur me sherbimin e ngjajshem te kerkuar nga AK-Posta e Kosoves.

Sipas ketyre sqarimeve komisioni i vleresimit vjen ne perfundim se OE' ProAudit Shpk"nuk eshte i pergjegjshem administrativisht dhe pasi qe eshte I vetmi OE qe ka ofertuar anulon aktivitetin e prokurimit:" Angazhimi i konsulentit të jashtëm për mbështetjen e procesit të Ristrukturimit në NPQ,Posta e Kosovës sha".

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

Kërkesa per sqarime tek AK-Posta e Kosovës Sh.A është dërguar përmes platformës elektronike te ankesave është dërguar me datë 15.08.2023 mirëpo deri me 21.08.2023 nuk kemi pranuar sqarimet, me datë 21.08.2023 kemi dërguar përsëri sqarimet përmes emalit tek zyrtaret e AK-Posta e Kosoves dhe po te njëjtën ditë kemi pranuar sqarimet e kërkuara.

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

Ne mbështetje te nenit 4.1.26 konstatojmë se OE **ProAudit " SH.P.K.** ne cilësinë e operatorit ekonomik ankues është palë me interes.

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - " ProAudit " SH.P.K.

1. Përgjigje në pretendimi nr.1

Pretendimi ankimor se është shkelur Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, përkatësisht ritenderimi si procedur e re duke angazhuar staftin profesional në ketë procedure dhe shtyerja e afatit kohor në sigurimin e ketyre shërbimeve janë disa nga demet që mund ti shkaktohen AK.

Është në përgjegjësin e AK-se te i vlerësoj demet qe mund te i shkaktohen AK-se ne raste te caktuara te retenderimit apo vonesat ne marrjen e shërbimeve.

Bazuar ne shkresat e lëndes , kërkesat e dosjes se tenderit dhe ne sqarimet e kërkuara konstatojm se ky pretendim ankimor është **i pa Bazuar.**

2. Përgjigje në pretendimi nr.2

Pretendimi ankimor se kemi te bëjmë me shkelje Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi paragrafi - 6. Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse, konstatojmë se është i pabazuar per faktin se kemi te bëjmë vetëm me nje ofertues ne ketë rast dhe nuk ka pasur diskriminim ne raport me ofertuesit tjerë.

Bazuar ne shkresat e lëndes , kërkesat e dosjes se tenderit dhe ne sqarimet e kërkuara konstatojm se ky pretendim ankimor është **i pa Bazuar.**

Përgjigje në pretendimi nr.3

Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale – duke konsideruar mundesit e aplikimit si Indivit apo OE dhe kriteri përmbajtësor CV e stafit si dhe vendimi nga BD për aprovimin e rregulloret për sistemantizimin vendeve të punës që në përmbatje nënkupton raport i pranimit të shërbimëve AK është dashur të konsideroj përmbatjen mbi formën. Ne lidhje me ketë pretenim ankimor kostatojm se kërkesa ne dosje te tenderit dhe nje njoftimin per kontratë kanë qenë te definuara çartë, shih deshmin e kërkesës si ne vijim:

Dëshmit e kërkuara lidhur me kërkesat e lartë cekura kanë qenë:

2.Një liste qe specifikon sherbimet e kryera nga ana e operatorit ekonomik (ose Grupit), shumën e kontratës datën dhe pranuesin. Listes duhet ti bashkangjitet kopje dëshmitë përkatëse; kur sherbimet janë bërë për nj autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij sherbimi-kryerje sherbimesh duhet kopj e kontratës dhe referenca apo raporti i pranimit të lëshuar ose të bashkë nënshkruara nga autoriteti i tillë kur sherbimet janë bërë për një operator privat, për dëshmi të kryerjes shërben kopja e çdo dokumenti t nënshkruar nga marresi i sherbimeve respektivisht kopja e kontratës dhe evidentimi i sherbimit.

3.OE duhet te paraqet nje raport që shte përgatitur ne 3 vitet e shkuara nga data e publikimit te njoftimit pe kontrate dhe që është i ngjashëm me atë që do të kërkohet në këtë angazhim.

AK-Posta e Kosoves Sh.A ka kërkuar sqarime me shkrim per këto dy pika tek operatori ekonomik dhe me datë 26.07.2023 OE ankues ka dërguar sqarime shtesë tek AK-Posta e Kosoves Sh.A ku nuk janë dorëzuar sqarimet sipas kërkesës se pikës 2 dhe 3 tek **Kerkesa teknike dhe profesionale** te parapara ne dosje te tenderit dhe njoftimin per kontratë.

AK-Posta e Kosoves po ashtu ka kërkuar sqarime shtesë tek AK-Ndermarrja Publik Banesore ku me datë 27.07.2023 kanë pranuar pergjigjen se Rregullorja për sistematizimin e vendeve te punës ne ndërmarrjen publike banesore sh.a me nr protokolli 01-475/3 te datës 25.03.2021 është punuar nga grupi punues i cili permbehet nga punonjësit e NPB-se , po ashtu ne ketë përgjigje potencohet se barrën kryesore e ka pasur Drejtori e Administrates ne përgatitjen e kësaj rregullore dhe Sekretari Koorporativ.

Sipas përshkrimit te larcekur , ne sqarimet e pranuara nga AK-Posta e Kosovës SH.A, ne shkresat e lëndes konstatojm se ky pretendim ankimor është i **PA Bazuar.**

Bazuar ne përshkrimin e bërë me sipër sipas shkresave, raportit te vleresimti, dosjes se tenderit, sqarimeve shtesë të lëndes, eksperti shqyrtues rekomandon panellin shqyrtues qe te mbetet ne fuqi

Vendimi i AK-së i datës 28.07.2023 mbi anulimin e aktivitetit te prokurimit dhe ankesa te konsiderohet si e **PA BAZUAR.**

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **POSTA E KOSOVËS SH.A**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **" ProAudit " SH.P.K.**

REPUBLIKA E KOSOVËS
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PRISHTINË/A
REPUBLIKA KOSOVA

Gani Nekaj